



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË

V E N D I M

Nr. 7526 datë 28.10.2021

“PËR MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E RE PËR ZHVILLIM ZONA 1, NJËSIA ADMINISTRATIVE MARIKAJ TË RISHIKUAR”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 13 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit Nr. 135, datë 13.2.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësine Administrative Marikaj, Bashkia Vorë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të zhvillimit si njësi zbatuese”, Vendimit Nr. 2195/3 prot, datë 19.03.2020 “Për miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 1 Njësia Administrative Marikaj”, Vendimit Nr. 6029 prot, datë 27.07.2020 “Për Miratimin e Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim Zona 1, Njësia Administrative Marikaj” dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Vorë Nr.84, datë 22.10.2021 “Kërkesë për miratimin e Nismës për Rishikimin e Dokumentit të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim Zona 1, Njësia Administrative Marikaj, Bashkia Vorë, të rishikuar miratuar me Vendim Nr.6029, datë 27.07.2020”;

VENDOSA:

1. Miratimin e Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 1 Njësia administrative Marikaj, të rishikuar miratuar me Vendim Nr.6029, datë 27.07.2020, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Dokumenti i Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 1 Njësia administrative Marikaj, Bashkia Vorë, të rishikuar miratuar me Vendim Nr.6029, datë 27.07.2020.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për dërgimin pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentat shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij, sipas ndryshimeve të miratuara.

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI

GENTIAN PICARI

